



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës

Durrës më, 16.01.2026

NJOFTIM

**ANULLIM I THIRRJES PUBLIKE:
“GRANTE PËR TË RINJTË NË MBËSHTETJE TË ZHVILLIMIT TË INICIATIVAVE
EKONOMIKE LOKALE”**

Në zbatim të Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 115 datë 24/12/2024 “Për miratimin buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2025 dhe Programin Buxhetor Afatmesëm 2025-2027” dhe Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 66 datë 11.11.2025 “Për Miratimin e Udhëzuesit për Mënyrën e Aplikimit “Për Implementimin e Skemës: Grante për të Rinjtë në Mbështetje të Zhvillimit të Iniciativave Ekonomike Lokale”, Bashkia Durrës më datë 21 nëntor 2025 ka shpallur thirrjen publike: “Grante për të rinjtë në mbështetje të zhvillimit të iniciativave ekonomike lokale”, të financuar nga buxheti i Bashkisë Durrës.

Për sa më sipër ju informojmë se:

Referuar Udhëzuesit të Aplikimit, pika 9.4 ‘Vlerësimi dhe përzgjedhja e aplikimeve’, Komisioni i Vlerësimit, ka kryer vlerësimin dhe më pas rivlerësimin e 8 (tetë) dosjeve të aplikimeve të dorëzuara pranë Bashkisë Durrës, në bazë të kushteve administrative dhe kushteve që kanë të bëjnë me aplikuesin si edhe me realizueshmërinë e idesë, planit të biznesit dhe financimit.

Pas përfundimit të fazës së dytë të procesit të vlerësimit dhe verifikimit të dokumentacionit, Komisioni i Vlerësimit ka vendosur, në unanimitet të plotë, anulimin e thirrjes publike, për arsye se dosjet e aplikimeve:

- nuk kanë përmbushur kriteret administrative, për shkak të mangësive në dokumentacionin e paraqitur nga aplikantët;
- nuk kanë përmbushur kriteret e Planit të Biznesit dhe të Financimit, sipas përcaktimeve të Udhëzuesit të Aplikimit.

Në këto kushte, Bashkia Durrës do të ri-shpallë thirrjen publike në faqen zyrtare të internetit të bashkisë. Sjellim në vëmendjen tuaj se aplikantët që kanë aplikuar në këtë thirrje, kanë të drejtën të ri-aplikojnë në thirrjen e radhës, e cila do të publikohet në ditët në vijim.

Duke ju uruar suksese në realizimin e idesë tuaj të biznesit, ju lutem vizitoni faqen zyrtare të internetit të Bashkisë Durrës (www.durres.gov.al) për më shumë informacione në lidhje me shpalljen e dytë publike: kushtet dhe afatet e aplikimit.